



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:197111

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05796733

A.C.nr.3160/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Bujar Muzaqi - Kryetar, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses F(A)K me vendbanim në rr. "...", Komuna Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës – Veri, në çështjen kontestimore për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.267/2019 datë 27.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses F(A)K me vendbanim në rr. "...", Tjegullore nd A1/21, Komuna Mitrovicë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.267/2019 datë 27.02.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, departamenti i përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.267/2019 datë 27.02.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

"... REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses F.K., nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se ajo është pronare e banesës e cila gjendet në rr. "...", ndërtesa A2/2, kati IV, me sipërfaqe prej 42 m2, banesa numër 13, e paditura është e detyruar të pranojë dhe të duroj regjistrimin e të drejtës së paditëses në pronësi në patundshmërinë e shënuar në librat e publik të tokës, e gjitha kjo në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, si e pa bazuar.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore..."

Kundër aktgjykimit C.nr.267/2019 datë 27.02.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë paditësja për shkak të: shkeljeve esenciale të LPK, vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose i njëjti të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tersi si e pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja F.K. nga Komuna Mitrovicë, ka paraqitur padi me datë 18.04.2019, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës – Veri, për vërtetimin e pronësisë.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore dëgjimit të palëve në procedurë dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.267/2019 datë 27.02.2020, me të cilin aktgjykim e ka refuzuar në tersi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se: *“... Me dispozitën e nenit 20 Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore, është paraparë se e drejta pronësore fitohet sipas ligjit, në bazë të punëve juridike dhe trashëgimisë. Paragrafi 2 i nenit të njëjtë është përshkruar se e drejta e pronës fitohet edhe me vendim të organit shtetëror, në mënyrë dhe me kushte të caktuara sipas ligjit...Në rastin konkret me aktvendim të lartëcekur të aktiviteteve komunale nga Mitrovica e T... nuk është dhënë banesa në shfrytëzim të përhershëm por në afat të caktuar deri në vendim përfundimtar të gjykatës andaj në këtë rast nuk mund të konsiderohet që paditësja me provë ka vërtetuar pronësinë e patundshmërisë në kontest, sepse për patundshmëri të njëjtë është kompensuar shuma me këmbim për shpronësim të tokës ndërtimore dhe objekte ndërtimore...”*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. I njëjti aktgjykim po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

I pabazuar qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me arsyetimin se dispozitivi është kundërtëhënës me arsyet e dhëna, dhe se aktgjykim mungojnë arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe ato të cilat janë dhënë janë të paqarta dhe kontradiktore, ngase sipas vlerësimit Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, ku arsyetimi i dhënë është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për faktin se gjykata e shkallës së parë del se ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve vendimtare si dhe për vlerësimin e tyre.

Në nenin 28.4 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore në mënyrë decidive thuhet se : *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”.*

Duke u bazuar në nenin 28.4 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore është nevojitur nga ana e paditëses të plotësohen të gjitha kushtet e parapara në këtë nen, për fitimin e pronësisë me mirëbesim të paluajtshmërisë e cila është objekt i kësaj procedure kontestimore.

Në bazë të shkresave të lëndës, nuk është vërtetuar se paditësja është mbajtëse me mirëbesim në kohën prej 20 vitesh në paluajtshmërinë e cila është objekt i kësaj procedure kontestimore.

Në nenin 7.1 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore në mënyrë decidive thuhet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Të pathemeltë Gjykata e Apelit i vlerëson edhe pretendimet ankimore të palës ankuese për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës ka konstatuar se në bazë të provave të nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor gjendja faktike del të jetë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, juridike dhe faktike lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pas ndikim në mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, të cilat si të rregullta dhe të bazuara në ligj në tërësi i pranon edhe gjykata ankimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu Gjykata e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës paditëse se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës i njëjti është marrë në bazë të nenit 450 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, e në pajtim me nenin 195 paragrafi 1, pika (d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.3160/2020 datë 07.06.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi